



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 28 dhe nenit 40, paragrafi 2, shkronja j e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 6, paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe paragrafi 6, të Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal, nr. 04/L-010 dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 31.01.2023, merr këtë

V E N D I M

1. Miratohet nisma e Kryetarit të Kryeqytetit për të hyrë në bashkëpunim ndërkomunal.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet ndërmjet komunave, si në vijim:
 - 2.1. Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës (Kryeqytetit);
 - 2.2. Komunës së Podujevës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Fushë-Kosovës, Komunës së Obiliqit dhe Komunës së Graçanicës.
3. Autorizohet Kryetari i Kryeqytetit që të fillojë konsultimet me komunat, si në pikën 2 të këtij vendimi, për përgatitjen dhe nënshkrimin e propozimmarrëveshjes për themelimin e bashkëpunimit ndërkomunal ndërmjet komunave të cekura si më lart.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtoritë e tjera relevante.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-020/01-24181/23, më 01.02.2023

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Faqe 1 nga 1